



## VENDIMI I PAPRANUESHMËRISË

**Data e miratimit: 08.06.2011**

**Nr. i rastit: 2011-17**

**Z. Faik Azemi**

Kundër

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 08 qershor 2011, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Antonio BALSAMO, Kryesues  
Znj. Magda MIERZEWSKA, anëtare  
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare

Asistuar nga  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Leena LEIKAS, zyrtare ligjore  
Znj. Stephanie SELG, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 5 maj 2011.

## **II. FAKTET**

1. Parashtruesi i ankesës është i punësuar si sekretar i një Shkolle të Mesme Bujqësore "A. Frashëri", në Prishtinë. Ai kishte nënshkruar kontratën e tij të parë të punës me Drejtorinë Komunale të Arsimit në muajin janar të vitit 2008. Më pas atij iu vazhdua kontrata për një vit, në bazë vjetore.
2. Sipas parashtruesit të kontratës, duke supozuar se kontrata e tij e punës po shkelej, ai ishte njoftuar nga drejtori i tij që ai mund t'i kryente vetëm ato punë që iu ishin caktuar nga drejtori i tij. Më tutje ai deklaroi se gjatë gjithë kësaj kohe asnjë detyrë nuk iu është caktuar.
3. Gjithashtu ai pretendon se ishte diskriminuar, posaçërisht për shkak se ai nuk posedon zyre të veten me emrin dhe pozitën e punës të vendosur në derë. Gjithashtu ai ka paraqitur ankesa rreth problemeve të veta që lidhen me punën e tij tek disa autoritete arsimore dhe të komunitetit, mirëpo pa sukses.
4. Në fillim të vitit 2011, atij iu ishin shqiptuar së paku dy vërejtje me shkrim për shkak të mos ardhjes në punë me rregull. Si pasojë, paga e tij iu kishte zbritur 10 për qind në një datë që nuk është e saktësuar pas 7 marsit 2011, kur edhe ishte njoftuar për shqiptimin e vërejtjes së dytë.

## **III. ANKESAT**

5. Parashtruesi i ankesës pretendon, duke u bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në Deklaratat dhe Konventat Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut, se ai është diskriminuar, dhe se e drejta e tij për mjete korrigjuese, e drejta për gjykim të rregullt, si dhe e drejta për ushtrimin e profesionit të tij iu ishin shkelur. Ai ankohet se dinjiteti i tij i ishte shkelur.

## **IV. LIGJI**

1. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos se a ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriterin e pranueshmërisë të përcaktuar në Rregulloren 29 të Rregullores së Punës.
2. Sipas Rregullës 25, paragrafi 1 i Rregullores së punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i të Kosovës, gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv.
3. Rasti i parashtruesit të ankesës ka të bëjë me një kontest në punë në mes të parashtruesit të ankesës dhe punëdhënësit të tij (Drejtoria Komunale të Arsimit në Prishtinë). Si pasojë, çështjet që janë ngritur në këtë ankesë nuk hyjnë në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-

it në Kosovë, mandat i cili kufizohet në çështjet që kanë të bëjnë me policisë, drejtësinë dhe doganat.

**PËR KËTO ARSYE,**

Paneli, njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, konstaton se sipas Nenit 29 (d) të Rregullores së Punës ankesa është e pabazuar, dhe

**SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.**

Për Panelin,



John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor

Antonio BALSAMO  
Kryesues i Panelit